



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

R R E G U L L O R E
E B O T I M I T T Ë R E V I S T A V E S H K E N C O R E
T Ë
U N I V E R S I T E T I T " I S M A I L Q E M A L I "
V L O R Ë

Miraturar nga Senati Akademik me Vendim nr. 98 datë 16.10.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

RREGULLORE

Për organizimin, funksionimin, financimin dhe bordet drejtuese të Buletinit Shkencor të UV-së dhe UniVlora Scientific Journal

Neni 1

Qëllimi i Rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin, funksionimin, përbërjen, kompetencat dhe procedurat e punës së Buletinit Shkencor të Universitetit 'Ismail Qemali' të Vlorës dhe UniVlora Scientific Journal (UVSJ), si dhe mënyrën e administrimit, financimit dhe botimit të tyre.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në:

1. Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"
2. Ligj nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to (ndryshuar me ligjin nr. 37/2022, datë 14.4.2022)
3. Ligj nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë"
4. Vendim nr.165, datë 21.3.2018 "Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë"
5. Vendim nr. 777, datë 26.12.2018 "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore"
6. Vendim nr. 99, datë 5.2.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 777, datë 26.12.2018, të këshillit të ministrave, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore"
7. Vendim nr.112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "profesor i asociuar" dhe "profesor" (ndryshuar me vkm nr. 808, datë 11.12.2019)"
8. Vendim nr. 607, datë 31.8.2016 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit (AKKSHI)"
9. Rregullore e Brendshme e UV-së (nenet 138-140)
10. Statuti i UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Neni 3

Qëllimi dhe misioni i publikimeve

1. Buletini Shkencor dhe UniVlora Scientific Journal (UVSJ) kanë për qëllim publikimin e punimeve origjinale kërkimore, studimeve, artikujve dhe analizave shkencore në fushat që mbulon Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV).
2. Publikimet synojnë promovimin e kërkimit shkencor, rritjen e cilësisë akademike dhe zhvillimin e bashkëpunimeve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. UVSJ është organ zyrtar shkencor me status ndërkombëtar dhe synon indekse shkencore ndërkombëtare (ISSN, DOI, SCOPUS, WoS, PubMed, etj.).

Neni 4

Forma e botimeve

1. Buletini Shkencor botohet në gjuhën shqipe, me përmbledhje në anglisht.
2. UniVlora Scientific Journal (UVSJ) botohet në gjuhën angleze.
3. Të dy publikimet mund të jenë në formë elektronike dhe/ose të shtypur, në përputhje me vendimet e redaksisë dhe mundësitë financiare të UV.
4. Frekuenca e botimit:
 - o Buletini Shkencor – minimalisht dy herë në vit.
 - o UniVlora Scientific Journal – minimalisht dy herë në vit.

Neni 5

Organizimi i revistave shkencore

1. Buletini Shkencor dhe UniVlora Scientific Journal (UVSJ) janë revista shkencore gjithëpërfshirëse, të organizuara në 6 seksione, në varësi të strukturës akademike të Universitetit 'Ismail Qemali':
 - Seksioni i Shkencave Teknike – nën redaktimin shkencor të FSHTN
 - Seksioni i Shkencave Natyrore – nën redaktimin shkencor të FSHTN
 - Seksioni i Edukimit – nën redaktimin shkencor të FSHH
 - Seksioni i Jurisprudencës – nën redaktimin shkencor të FSHH
 - Seksioni i Ekonomik – nën redaktimin shkencor të FE
 - Seksioni i Shëndetit – nën redaktimin shkencor të FSH
2. Përmbajtja e revistës është e ndarë sipas seksioneve të mësipërme. Seksioni do të pasqyrohet vetëm nëse do të ketë artikuj të miratuar të fushës.
3. Nëse do të kërkohet Edicion Special ai do të ketë artikuj vetëm të fushës së Edicionit Special të kërkuar.

Neni 6

Organizimi institucional

1. Publikimet janë nën varësinë e Rektoratit të Universitetit të Vlorës, në bashkëpunim me Sektorin e Bibliotekës dhe Botimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

2. Strukturat përgjegjëse janë:

- a) Bordi Shkencor;
- b) Bordi Redaksional (Redaksia botuese);
- c) Sektori i Botimeve dhe Drejtoria e Kërkimit Shkencor si mbështetje institucionale.

Neni 7

Bordi Shkencor i Revistave Shkencore të UV-së

1. Bordi Shkencor i Revistave Shkencore të UV-së është organi këshillimor dhe mbikëqyrës i cilësisë shkencore të revistave dhe botimeve UniVlora.
2. Përbërja:
 - Kryeredaktori Shkencor i përgjithshëm – Rektori i UV-së
 - Kryeredaktorët Shkencorë të Seksioneve
 - Redaktorët shkencorë (recensentët) e Seksioneve, nga UV dhe institucionet kërkimore vendase e të huaja
3. Emërimi i kryeredaktorët shkencorë të seksioneve bëhet nga Rektori, nga propozimet e ardhura nga drejtuesit e njësive kryesore.
4. Emërimi i redaktorët shkencorë bëhet nga Rektori, nga propozimet e ardhura nga kryeredaktorët shkencorë të seksioneve. Anëtarët e propozuar duhet të angazhohen në kryerjen e opionencave shkencore, së paku një herë në vit.
5. Rektori në çdo kohë mund ta rishikojë emërimin e bërë, në bazë të përmbushjes së angazhimit të anëtarëve të bordit si recensentë shkencorë.
6. Bordi Shkencor në nivel kryeredaktorësh mbledhet së paku një herë në vit, sipas kërkesës së Kryeredaktorit të Përgjithshëm. Bordi zhvillon konsultime dhe miratime online, kryesisht në adresat elektronike zyrtare të UV-së.

Neni 8

Detyrat e Bordit Shkencor të Revistave Shkencore të UV-së

Bordi Shkencor i Revistave Shkencore të UV-së, në nivel kryeredaktorësh:

1. Harton dhe miraton politikat e zhvillimit shkencor të revistave shkencore dhe botimeve akademike;
2. Mbikëqyr cilësinë akademike të përmbajtjes;
3. Sugjeron recensentë dhe ekspertë të fushave përkatëse;
4. Jep rekomandime për indeksime shkencore ndërkombëtare;
5. Rekomandon miratimin e numrave të botuar.

Neni 9

Bordi Redaksional i Revistave Shkencore të UV-së

1. Bordi Redaksional është organi ekzekutiv që administron procesin e plotë editorial dhe publikimin e revistës.
2. Përbërja:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

- Kryeredaktori i përgjithshëm;
 - Zëvendëskryeredaktori (nga UV ose partner ndërkombëtar);
 - Sekretari editorial (managing editor);
 - 6 Kryeredaktorë seksionesh;
 - Përfaqësues i IT (faqja web).
 - Kryeredaktori Shkencor i Edicionit Special (nëse ka)
3. Bordi Redaksional ngrihet nga Rektori i UV-së, mbi bazën e propozimeve të drejtuesve të njësive bazë dhe specialistëve ndihmës-akademikë.
4. Mandati i Redaksisë është 3 vjet, me të drejtë rinovimi.

Neni 10

Detyrat e Bordit Redaksional

Bordi Redaksional ka për detyra:

1. Miraton planin vjetor të botimeve dhe fushat tematike;
2. Publikon thirrjet për artikuj ("Call for Papers");
3. Zbaton procesin e vlerësimit të dyfishtë anonim (double blind peer review);
4. Vendos për pranimin, refuzimin ose rishikimin e artikujve;
5. Kujdeset për korrektesën gjuhësore dhe shkencore të materialeve;
6. Mbikëqyr funksionimin teknik të faqes elektronike të revistës;
7. Përgatit raportin vjetor të punës dhe ia përcjell Rektoratit.

Neni 11

Sekretari editorial

1. Sekretar editorial (managing editor) i revistave shkencore të UV-së emërohet si rregull specialisti i botimeve të Sektorit të Bibliotekës dhe Botimeve të UV-së dhe është përgjegjës për mbështetjen administrative dhe teknike të procesit të botimit shkencor.
2. Detyrat e sekretarit editorial janë:
 - a) *Koordinimi i komunikimit* ndërmjet autorëve, recensentëve, redaktorëve dhe bordit shkencor.
 - b) *Pranimi, regjistrimi dhe arkivimi* i dorëshkrimeve të reja dhe dokumenteve përkatëse.
 - c) *Verifikimi paraprak* i përputhshmërisë së dorëshkrimeve me udhëzimet e revistës (formatimi, struktura, referencat, aspektet etike).
 - d) *Organizimi i procesit të rishikimit shkencor* (peer review) dhe ndjekja e ecursisë së tij sipas afateve.
 - e) *Mbajtja e regjistrimit elektronik* të dorëshkrimeve dhe versioneve të tyre gjatë procesit editorial.
 - f) *Përgatitja e korrespondencës zyrtare* me autorët dhe recensentët (njoftime, vendime redaksionale, kërkesa për korrigjime).
 - g) *Asistimi i redaktorit përgjegjës dhe kryeredaktorit* në përgatitjen e numrave të rinj të revistës për botim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- h) *Kontrolli përfundimtar i materialeve* para publikimit (layout, metadata, korrektura gjuhësore dhe teknike, plagjiatura).
- i) *Ruajtja e konfidencialitetit* gjatë gjithë procesit editorial dhe pas botimit.
- j) *Raportimi periodik* për ecurinë e punës tek Kryeredaktori dhe Bordi Shkencor.

Neni 12 **Procesi editorial**

1. Autorët dorëzojnë punimet sipas udhëzimeve teknike të publikuara në faqen zyrtare të revistës.
2. Çdo artikull kalon:
 - Kontrollin paraprak nga redaksia;
 - Vlerësimin anonim nga dy recensentë të pavarur;
 - Vendimmarrjen përfundimtare nga Kryeredaktori.
3. Botimi final përfshin rishikime, korrektim dhe dizajn teknik para publikimit online.
4. Edhe pas botimit, artikulli mund të korrektohet ose tërhiqet përfundimisht nga revista dhe databasat e saj, nëse Bordi Editorial konstaton gabime të kapura / raportuara me vonesë.

Neni 13 **Financimi**

1. Financimi i publikimeve sigurohet nga:
 - Buxheti i Universitetit të Vlorës;
 - Projekte kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - Të ardhura nga tarifa e publikimit, sipas miratimit në Bordin e Administrimit të UV-së.
 - Të ardhura nga shërbime redaktuese ose citime.
 - Kontribute vullnetare ose sponsorizime, sipas legjislacionit në fuqi;
2. Fondet administrohen nga Sektori Ekonomik i UV-së, në bashkëpunim me Bordin Redaksional dhe Rektorin.
3. Shpenzimet mbulojnë:
 - Redaktim, dizajn dhe publikim online/ të shtypur;
 - Mirëmbajtje IT dhe liçenca;
 - Honorare për recensentë ose anëtarët e Bordit Redaksional.

Neni 14 **E drejta e autorit dhe etika shkencore**

1. Të gjitha punimet duhet të jenë origjinale dhe të papublikuara më parë.
2. Autorët mbeten përgjegjës për përmbajtjen dhe saktësinë e të dhënave.
3. Plagjiatura, autoplagjiatura dhe shkeljet etike ndalohen rreptësisht dhe sjellin refuzim ose tërheqje të artikullit.
4. Revista ndjek udhëzimet e COPE – Committee on Publication Ethics.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

Neni 15

Regjistrimi dhe arkivimi

1. Të gjitha numrat regjistrohen me ISSN dhe ruhen në arkivën elektronike të UV.
2. Materialet publikohen në faqen zyrtare: <https://uvjournals.univlora.edu.al>.
3. Një kopje fizike e çdo numri print depozitohet në Bibliotekën e UV.

Neni 16

Simbolet dhe identiteti grafik

1. Buletini Shkencor dhe UVSJ mbajnë logon zyrtare të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.
2. Faqet elektronike, formatet PDF dhe materialet promocionale respektojnë identitetin vizual institucional.

Neni 17

Raportimi dhe miratimi

1. Redaksia përgatit raportin vjetor për aktivitetin e revistës, i cili miratohet nga Rektorati.
2. Çdo ndryshim në rregullore miratohet nga Senati me propozim të Rektorit.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit.

KRYETARE E SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AURELA SALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

ANEKSE

Aneksi 1: Procesi editorial

PROCESI EDITORIAL / EDITORIAL PROCESS

1. Dorëzimi i artikullit / Submission

Autori dorëzon artikullin përmes platformës elektronike ose në adresën zyrtare të redaksisë. Artikulli duhet të përmbajë të gjitha elementet sipas udhëzimeve për autorët (titulli, abstrakti, fjalët kyçe, referencat, etj.).

2. Kontrolli i paraprak / Initial Check

Redaktori ekzekutiv (Managing Editor) verifikon nëse dorëzimi përputhet me kërkesat formale dhe tematike të revistës (formati, citimet, struktura, etika e publikimit). Në këtë fazë mund të kërkohej korrigjim paraprak ose artikulli mund të refuzohet pa dërguar për recensim.

3. Dërgimi për recensim / Peer Review

Artikulli që kalon kontrollin e parë nga Redaktori ekzekutiv dërgohet tek Kryeredaktori shkencor i Përgjithshëm i Revistës (Editor-in-chief) dhe tek Kryeredaktorët shkencorë të Seksionit përkatës (Section's Editor-in-chief) / Edicionit special.

Këta të fundit e nisin dorëshkrimin për vlerësim (pa emër autori dhe affiliation - proces "double blind") tek dy recensentë të Bordit të Oponentëve (Reviewer Board).

Recensentët vlerësojnë origjinalitetin, metodologjinë, qartësinë dhe rëndësinë shkencore, sipas formularit të vlerësimit.

4. Vendimi editorial / Editorial Decision

Bazuar në vlerësimet e recensentëve, redaksia merr një nga vendimet e mëposhtme:

- Pranohej për botim (Accepted)
- Pranohej me korrigjime (Minor/Major Revision)
- Refuzohet (Rejected)

Në rast se kërkohej rishikim, artikulli i kthehet autorit për përmirësim dhe më pas rivlerësohet nga redaksia ose recensentët.

5. Redaktimi dhe korrektura / Editing and Proofreading

Pas pranimit, artikulli redaktohet përfundimisht, nën monitorimin e Redaktorit ekzekutiv, për plagjiaturë, drejtshkrim, përputhje teknike dhe stil shkencor. Autori miraton versionin përfundimtar para publikimit.

6. Publikimi / Publication

Artikulli botohet në numrin përkatës të Buletinit Shkencor ose UniVlora Scientific Journal, dhe bëhet i qasshëm në faqen zyrtare të Universitetit të Vlorës, në seksionin "Open Access Publications".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

7. Paspublikimi / Postpublication

1. Në rast se gjenden gabime nga vetë autorët ose lexuesit në artikuj të botuara në versionin e tyre përfundimtar, revista pranon korrigjim ose tërheqje të artikullit. Korrigjimet mund të jenë në forma dhe nivele të ndryshme përfshirë këtu:
 - a) Korrigjimi i gabimeve të vogla brenda tekstit të një punimi shkencor. Këto gabime nuk ndikojnë në rezultatet dhe konkluzionet e studimit. Ato mund të përfshijnë gabime ortografike, gabime në pjesë të ndryshme të artikullit, gabime në emra etj. Këto gabime korrigjohen nga redaktori i seksionit respektiv të revistës brenda një kohe të shkurtër, pasi ka informuar kryeredaktorin, i cili konfirmon aprovimin e korrigjimeve.
 - b) Korrigjimi i gabimeve të mëdha, të cilat mund të çojnë në konkluzione të gabuara, metodologji apo analizim të të dhënave në mënyrë të gabuar, gabime në referenca, heqja/shtimi i një nga autorëve etj. Këto korrigjime kanë nevojë të bëhen sa më shpejt është e mundur pas gjetjes së gabimit/eve. Korrigjimi kërkohet nga bordi editorial / redaktori i seksionit, i cili ia përcjell propozimet e veta kryeredaktorit. Ky i fundit merr vendimin përfundimtar për pranimin e këtyre korrigjimeve.
 - c) Në të dyja rastet (gabimet e vogla apo të mëdha), artikulli përditësohet, si dhe njoftohen të gjitha databasat ku revista është e indeksuar për ndryshimet përkatëse.
2. Në raste të rralla, një artikull mund të tërhiqet për arsye madhore si plagjaturë, fabrikim i të dhënave, gabime të mëdha gjatë procesit të realizimit të kërkimit etj.
 - a) Në këtë rast revista informon lexuesit për tërheqjen e artikullit, si dhe databasat e ndryshme në të cilat është e indeksuar.
 - b) Në varësi të arsyes për tërheqjen e artikullit, kjo mund të sjellë pasoja për autorët si mos pranim i artikujve në të ardhmen etj.
3. Gabimet mund të identifikohen nga autorët e artikullit apo/edhe nga lexuesit. Në rastin se një gabim gjendet nga autorët, ata menjëherë informojnë kryeredaktorin e revistës, i cili duke ndjekur procedurat e sipërpërmendura vendos për korrigjimin apo tërheqjen e artikullit.
4. Në rastet kur informimi për gabime të mundshme bëhet nga lexuesit, kryeredaktori informon autorët e artikullit mbi pretendimin e ngritur. Brenda 15 ditësh, autorët përcjellin përgjigjen e tyre mbi pretendimet e ngritura. Në rast se ata pranojnë gabimet e mundshme, ndiqet procedura e mësipërme. Në rast se nuk panohen pretendimet ngritura, kryeredaktori ngre një komision për të shqyrtuar çështjen. Ky komision përbëhet nga tre persona (redaktori i seksionit si dhe dy anëtarë të tjerë të bordit editorial). Propozimi i komisionit i përcillet kryeredaktorit i cili merr vendimin përfundimtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Aneksi 2: Formulari i vlerësimit nga recensentët

FORMULARI I VLERËSIMIT NGA RECENSENTËT REVIEWER EVALUATION FORM

Titulli i artikullit / Article title: _____

Kodi i dorëzimit / Submission code: _____

Data e marrjes / Date received: _____

Emri i recensentit / Reviewer's name: _____

Institucioni / Institution: _____

Email: _____

Jeni dakort me publikimin e vlerësimit (review) tuaj? ☐PO ☐JO

I. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM / GENERAL ASSESSMENT

Nr.	Elementi / Criterion	Përshkrimi / Description	Vlerësimi / Rating (1–5)
1	Abstrakti / Abstract	Qartësia, përmbledhja dhe përputhja me përmbajtjen	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5
2	Rëndësia shkencore / Scientific significance	Kontributi i punimit në fushën përkatëse	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5
3	Originaliteti / Originality	Ide të reja, qasje origjinale, kontribute inovative	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5
4	Struktura dhe organizimi / Structure and organization	Logjika, qartësia e ndarjeve, përfundimet	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5
5	Metodologjia / Methodology	Përzgjedhja dhe zbatimi i metodave kërkimore	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5
6	Rezultatet / Results	Qartësia, vlefshmëria dhe mbështetja e të dhënave	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5
7	Analiza dhe interpretimi / Analysis and interpretation	Thellësia e analizës dhe vlefshmëria e rezultateve	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5
8	Konkluzionet / Conclusions	Qartësia, përmbledhja dhe koherenca me studimin e paraqitur	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5
9	Referencat / References	Aktualiteti, cilësia dhe korrektësia e burimeve	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5
10	Përdorimi i gjuhës / Language and style	Qartësia, korrektësia dhe koherenca e tekstit	☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

II. KOMENTE PËR AUTORIN / COMMENTS FOR THE AUTHOR

(Ju lutemi, jepni komente konstruktive për përmirësimin e punimit / Please provide constructive comments for improving the paper)

1. Vlerësim i përgjithshëm (pikët në total) / General assessment (total)

2. Pikat e forta të punimit / Strengths of the paper

3. Pikat që kërkojnë përmirësim / Points needing improvement

III. KOMENTE PËR REDAKSINË / COMMENTS FOR THE EDITORIAL BOARD

(Këto komente nuk i dërgohen autorit / These comments are not shared with the author)

IV. REKOMANDIMI I PËRGJITHSHËM / OVERALL RECOMMENDATION

- ☐ Pranohet pa ndryshime / Accept as is
☐ Pranohet me korrigjime të vogla / Accept with minor revisions
☐ Pranohet me korrigjime të mëdha / Accept with major revisions
☐ Nuk rekomandohet për botim / Reject

Data / Date: _____

Nënshkrimi i recensentit / Reviewer's signature: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Aneksi 3: Udhëzimet për autorët

UDHËZIMET PËR AUTORËT (AUTHOR'S GUIDELINE)

Buletini Shkencor dhe UniVlora Scientific Journal botojnë kërkime me cilësi të lartë, të rishikuara nga kolegë (peer-reviewed), në disa disiplina shkencore.

Autorët ftohen të paraqesin punime origjinale, të pabotuara më parë, në përputhje me udhëzimet e mëposhtme.

1. Llojet e Dorëshkrimeve

Revista pranon llojet e mëposhtme të punimeve:

- Artikuj kërkimorë origjinalë (Original Research Articles) – raporte të plota mbi rezultate të rëndësishme kërkimore.
- Artikuj përmbledhës (Review Articles) – analiza të gjera dhe kritike mbi tema specifike.
- Komunikime të shkurtra / Shënime (Short Communications / Notes) – njoftime të shkurtra mbi zbulime apo metoda të reja.
- Studime rasti (Case Studies) – për seksionet e Shëndetit, Juridikut ose Edukimit; shembuj ilustrues me përfundime të qarta.
- Punime teorike ose konceptuale (Theoretical or Conceptual Papers) – analiza ose propozime që avancojnë teorinë apo kornizat konceptuale.

2. Gjuha

- Dorëshkrimet duhet të dorëzohen në gjuhën angleze.
- Autorët janë përgjegjës për qartësinë, gramatikën dhe terminologjinë e saktë.
- Dorëshkrimet nga autorë që nuk kanë anglishten gjuhë amtare duhet, në mënyrë ideale, të rishikohen për cilësinë e gjuhës përpara dorëzimit.

3. Struktura e Dorëshkrimit

Autorët duhet të ndjekin një strukturë të qartë dhe të qëndrueshme.

Artikuj kërkimorë origjinalë:

1. Titulli
2. Autori(t) dhe afilacioni(et)
3. Abstrakti (150–250 fjalë) – duke përfshirë qëllimin, metodat, rezultatet, përfundimet
4. Fjalë kyçe (3–6 terma)
5. Hyrja
6. Metodot / Materialet dhe Metodot
7. Rezultatet
8. Diskutimi
9. Përfundimet
10. Falënderimet (nëse ka)
11. Referencat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Artikuj përmbledhës / Punime teorike:

1. Titulli, Autori(t), Abstrakti, Fjalët kyçe
2. Hyrja
3. Trupi kryesor – i organizuar sipas nënkapitujve tematikë
4. Përfundime / Drejtime të ardhshme
5. Referencat

Udhëzime për formatimin:

- Gjatësia e dorëshkrimit: 5–12 faqe (artikuj kërkimorë), 10–20 faqe (artikuj përmbledhës)
- Fonti: Times New Roman, madhësia 12 pt, hapësirë e dyfishtë
- Kufijtë e faqes: 2.5 cm në të gjitha anët
- Figurë dhe tabela: të përfshira në tekst, të numëruara në mënyrë të njëpasnjëshme
- Referencat: sipas APA (7th edition) ose Vancouver style, në varësi të seksionit (kontrolloni kërkesat për çdo seksion)

4. Aspektet Etike

- Dorëshkrimet duhet të jenë origjinale dhe të mos jenë në proces shqyrtimi në ndonjë revistë tjetër.
- Të gjitha studimet që përfshijnë njerëz ose kafshë duhet të jenë në përputhje me standardet etike dhe të kenë miratim nga komisionet përkatëse etike.
- Autorët duhet të deklarojnë konfliktet e interesit dhe të përmendin burimet e financimit.
- Plagjiatura ndalohet rreptësisht; revista mund të kërkojë raport të ngjashmërisë.

5. Procesi i Dorëzimit

- Dorëshkrimet dorëzohen përmes portalit online të revistës ose me email, në format Word (.docx).
- Çdo dorëzim duhet të përfshijë:
 - Faqen e titullit (me të dhënat e autorit dhe afilacionin)
 - Dorëshkrimin kryesor
 - Figurat / tabelat në format të redaktueshëm
 - Dokumentin e miratimit etik (nëse aplikohet)
- Autorët do të marrin konfirmim të pranimit pas dorëzimit.

6. Rishikimi nga Koleget (Peer Review)

- Të gjitha dorëshkrimet i nënshtrohen rishikimit të dyfishtë të fshehtë (double-blind peer review) nga ekspertë të fushës.
- Kriteret e vlerësimit përfshijnë: originalitetin, cilësinë shkencore, qartësinë, metodologjinë, rëndësinë dhe respektimin e standardeve etike.
- Autorëve mund t'u kërkojë të bëjnë ndryshime dhe ta ridorëzojnë punimin sipas komenteve të recensentëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

7. Referencat

- Referencat duhet të jenë të sakta dhe të plota.
- Përdorni:
 - Stilin APA (7th edition)

Shembuj:

- APA: Smith, J. (2022). *Title of the article. Journal Name*, 10(2), 45–60.

8. Të Drejtat e Autorit dhe Liçencimi

- Autorët ruajnë të drejtën e autorit, por i japin revistës të drejtën ekskluzive të botimit.
- Revista funksionon sipas parimeve të aksesit të hapur (open access), duke lejuar shpërndarjen e lirë të materialeve me kusht që të citohet burimi në mënyrë të duhur.